BANKA KOMBËTARE E SHQIPNÍS
BANCA NAZIONALE D'ALBANIA

RELACION

i

BILANÇIT ME 31 DHETUER 1939-XVIII

paraqitun

MBLEDHJES SË PËRGJITHËSHME TË AKSIONISTAVET

datë 16 Prill 1940-XVIII

BKSH

ВКSH

ВКSH

ВКSH

BANKA KOMBËTARE E SHQIPNÍS
BANCA NAZIONALE D'ALBANIA

RELACION

i

BILANÇIT ME 31 DHETUER 1939-XVIII

paraqitun

MBLEDHJES SË PËRGJITHËSHME TË AKSIONISTAVET

datë 16 Prill 1940-XVIII

BKSH

BKSH

Stab. F. DAMASSO - Roma 1940

KËSHILLI ADMINISTRATIV

Shk. T. Antonio Mosconi	– Kryetar
Z. Federico Brunner	– Nënkryetar
Z. Augusto Callens	– »
Av. Amedeo Gambino	– Këshilltar Delegat
Z. Francesco Sforza	– Këshilltar dhe antar i Komitetit
Dr. Adolfo Nesi	– Këshilltar
Dr. Ernesto Rizzo	– »
Z. Nush H. Topalli	– »
Rag. Ugo Viali	– »
Z. Lale N. Zuber	– »

SINDIKËT

Dr. Ettore Cauli — Z. Zihni Hamzaraj

Dr. Alfredo Roncuzzi

BKSH

ВКSH

RELACION I KËSHILLIT

BKSH

BKSH

Situata e ré politike lumturisht e krijueme në prillin e vjetit të kaluem e ka shty Shqipnìn drejt një trasformimi të thellë të strukturës së saj'ekonomike.

Qysh nga çasti i parë, me anën e « konvensjonit ekonomiko-doganuer-valutar » të 20 prillit 1939, shënohesh një vendosje e thjeshtë e marrëdhanjeve ekonomike ndërmjet Italìs dhe Shqipnìs. U duk kjartas kështu se të dy Shtetet bashkoheshin në mënyrë të pazgjidhëshme edhe në jetën ekonomike. Lihesh e lirë hymja e prodhimeve shqiptare ne tregun italian e çdukesh njëkohësisht çdo pengim për transfuzjonin e kapitaleve e të inisjativave ekonomike italiane në tokën shqiptare. Kjo krijonte jo vetëm mundësìn e një vënd zbrazjeje të konsiderueshëm për prodhimet e zakonëshme shqiptare, por mbi të gjitha krijonte edhe bazat për vleftësimin e burimevet themelore të Vëndit përmjet aktivitetesh të reja ekonomike që sillshin shtimjen në punë të mjeteve me randësì të cilat nuk do t'i japin menjëherë frytat e tyne. U jepesh në këtë mënyrë frymë dhe jet' e rè prodhimeve e lëvizjeve, qoft'edhe në masë e me rithm jo të njësojshëm në sektorët e ndryshëm.

I shpejtë, qysh nga prilli 1939, ka qenë fillimi i *veprave botore* tue zanë fill nga rindërtimi i rrugëve kryesore që ekzistojshin ma parë për të kalue mbas pak

muejsh në ndërtimin e arterjeve të reja të përshtatëshme ma së miri për të lidhun vëndet e ndrystme përbrënda ashtu edhe për të lehtësue lëvizjet me Vëndet kufitarë. E pak nga pak, gjatë pak muejve, janë fillue vepra të mëdha bonifikimi, tue nisun nga fusha e Durrsit, ndërsa ka fillue ngrehja e godinave dhe e veprave të tjera për dobì publike, si ujëpruesa në qendrat kryesore urbane të destinueme m'u përtrì në një kohë të shkurtën simbas planeve regulluese moderne.

Në *bujqësì,* me të vërtetë, të korrunat nuk mundin veçse të pasqyrojnë gjëndjen e së shkuemes. Asht ndì kështu pamjaftësija e të korrunave të drithnave të cilat prej kohësh kanë qenë ma të pakta kundrejt nevojave të konsumit. Prej këndej lindi nevoja e ndërhymjes direkte të fuqivet publike për me sigurue furnizimet e grunit e të misrit me çmime të favorshme për konsumatorët. Prodhimet e tjera bujqësore si ullijt dhe duhani, tue marrun parasysh sasinat, nuk janë largue shumë nga ato të vieteve të kaluem: por, si çmime, janë shënue përfitime të mëdha për produktorët për shkak të mundësive ma të mira që u përmendën ma naltë në të gjetunit e tregjeve të shitjes. Kto mundësì ma të mira janë shfaqun së tepri me fitime të dukëshme për prodhimet e blegtorìs, si leshna, lëkurë, djathna.

Në *industrì,* shtyjtja drejt një prodhimtarije ma të dendun ka qenë e shpejtë. Jo vetëm për sipërmarrjet e mëdha basilare midis të cilave zanë vendin e parë sipër-

marrjet ekstrative (vajguri e serë, minerale kromi e kupriferi), por edhe për të gjitha sipërmarrjet e tjera si centralet termoelektrike, fabrikat e çimentos e të tugllave, mullijt e maqinat e vajit, kryporet, fabrikat e cigareve, distilerìt e alkolit dhe stabilimentet e tjera për fabrikimin e birrës, fabrikimin e sapunit e të sendeve të tjera të konsumit të shpejtë. Të gjitha kanë përfitue, qoft'edhe në masë të ndryshme, nga situata e ré. E kanë mbrrijt me përfitue edhe ato të pakta industrì, jeta e supozueme e të cilave mvaresh nga barrjerat doganore që u hoqnë me rastin e bashkimit me Italinë. Në fakt, qysh në çastin e parë u muarrën masa transitore në favor t'atyne aktiviteteve që mund të kishin arësye m'u druejt nga konkurenca e industrìs italiane. Të tilla masa muerrën mandej karakter vazhdueshmënije përmjet përcaktimeve që u përfunduen në fruer nga Komiteti Mikst Italo-Shqiptar i parapàm prej konvensjonit të 20 prillit 1939.

Forcimi dhe shvillimi i aktiviteteve industriale që ekzistojshin ma parë asht gja e dukëshme. Por një shtytje ma të gjanë të Shqipnìs drejt përparimit e paraqesin inisjativat industriale që kanë shkue tue u konkretue. Shquhet mbi çdo tjetër vleftësimi që ka fillue t'u jepet xeheve të mineralit të hekurit, inisjativë kjo që sjell vepra të mëdha të cilat nisin qysh nga ndërtimi i hekurudhës Durrës-Elbasan deri te krijimi i puseve idroelektrike. Ka me fillue kështu të vihet në përdorim fuqija e madhe e energjìs që paraqesin lumenjt e Shqipnìs, energjì e cila

BKSH

do të mundë t'ushqejë me çmime të favorshme një industrì premtuese elektrokimike. Kthejnë në këtë drejtim projekte të ndryshme që do të kenë një realizim jo të largët, ndërsa po shkojnë drejt një realizimi të afërm inisjativa të tjera industriale që i janë kushtue punimit të pasunive bujqësore e blegtorale.

Veprimtarija e dendun produktuese, veçanërisht ajo në fushën e veprave botore ka sjellë përdorimin e plotë të të gjitha burimeve njerzore e materjale që ka Shqipnija. Puna e dorës ka pa përfitimet ma të gjana, tue gjetë lehtësisht fushë veprimi me kushte shumë ma të shpërblyeshme se në të kaluemen. Por janë favorizue edhe të gjith' ata që zotnojshin pasunina të çdo lloji. Kjo asht vërtetue për pronat urbane të kërkueme shpesh për nevojat e shpejta të banimit dhe për pronat rurale mbi vleftën e të cilave asht projektue parashikimi i liveleve ma të nalta të fitimeve t'ardhme. Gjithashtu mbajtësat e sendeve e mallnave të konsumit dhe ata të landëve e të mjeteve për prodhim (si p. sh. autoqerret) kanë pam pa tjetër të mirat e situatës së ré.

Ka rezultue një shtes' e madhe në blemje e për pasojë një kërkes' e dendun në gjanat e konsumit që ka rrjedhun së bashku me kërkesën e landëve të nevojshme për produktimin e rritun. Kjo situatë nuk mund të mos influenconte në *livelin e çmimeve* me shumic' e me pakicë që kanë pasun tendencë të qëndrueshme shteset me gjith se, sikurse u tha, furnizimet e drithnave janë ba me çmime

të favorshme për konsumatorët. Por, para së, gjithash, shtesa e kërkesës ka influencue mbi *trafigjet* (lëvizjet) e mbi *tregtinat*, të cilat kanë shënue në çdo sektor një shvillim të madh tue mbrrijt çifra jashtzakonisht të nalta e tue shkaktue edhe ktu inisjativa dhe mundësìna të reja vleftësimi, edhe të shpejtë, të pajosjes me mjete ashtu edhe të klasave prodhuese.

* * *

Në këtë ecje premtuese të ekonomìs së Vendit Banka e jonë ka shvillue veprimin e sajë me dëshirë t' apasjonueme e me kuptim të naltë të detyrës, tue pasë për qëllim që të bahesh gjithnjë ma shkaktare e interesit të përgjithëshëm.

Pik së pari, si detyrë të parë të kompetencës së posaçme të sajë, Banka e jonë asht interesue me iu ba ballë nevojave të një qarkullimi ma të madh në lidhje me shtesën e eksigjencave të prodhimtarìs e të lëvizjeve tregtare. Në pregatitjen e mjeteve të nevojshme kemi pasun përkrahjen e vlefshme të Banca d'Italia e të Zecca Mbretnore të Romës, së cilës i qenë lëshue - në mbështetje të nenit 14 të Konvensjonit të përmendun datë 20 prill 1939 - shtypja e bankonotave dhe konjimi i monedhave për Shqipnìn. Oficinat e Banca d'Italia, lavdì pajosjes së tyne të përsosun, kanë ba që të dorëzohen me shpejtësì të veçantë sasina të mjaftueshme biljetash të reja nga franga pesë dhe njëzet, të vueme në qarkullim

me kohë, dhe janë tue plotsue furniturën e biljetave nga njëqind franga. Po në këtë kohë Zecca Mbretnore, tue kapërxye vështirsina të ndryshme, ka provedue me zotsìn e sajë të provueme, konjimin e monedhave të reja argjendi nga lek 10 e lek 5, akmonitali prej lek 2, lek 1, lek 0,50 e lek 0,20 dhe brunxalumini prej lek 0,10 e lek 0,05.

Qarkullimi i bankonotave nga Fr. sh. 10,5 miljonë më 31 dhetuer 1938 ka mbrrijtun në fund të 1939-ës në Fr. sh. 26,3 miljonë, mbassi pati kapun në fundin e nanduerit sasìn ma të naltë prej Fr. sh. 27,5 miljonë. Në të njajtën kohë shuma e përgjithëshme e *monedhave divizjonale të lëshueme* ka kalue nga Fr. sh. 2 miljonë në Fr. sh. 3,5 miljonë, me tendencë që të shtohet edhe mà.



Kto shtesa qarkullimi nuk sjellin në vetvehte asnjë farë cenimi të monedhës e të kredìs e nuk janë tjetër veçse efekti i zgjanimit të prodhimtarìs e të lëvizjeve. Ky zgjanim, në të vërtetën, për sa shikon pjesën financjaro-monetare, ka qenë favorizue dhe mbajtun nga



disponibilitete të hollash me burim italian, qoftë për pagesën e një pjese të madhe të veprave botore, qoftë për formimin e kapitaleve të inisjativave të reja kryesore, qoftë për pagimin e mallnave të vendosuna në tregjet italiane. Rrjedhja e vazhdueshme e disponibiliteteve të tilla ka qenë elementi që ka sjellë shtesën e qarkullimit monetar në Shqipnì dhe ka qenë veç kësajë ma e madhe nga ajo që shifet prej sasìs së qarkullimit në fjalë, ndërsa ka shkue tue formue ma së tepri depozita fondesh në të holla që përfaqësojnë tash për tash disponibilitete të lira të privatëve e t'Enteve publike në Shqipnì.

Kjo vërtetohet n'ecjen e *mbulesës së qarkullimit* që asht shtue dal nga dalë në masë ma të madhe nga shtesa e qarkullimit të bankonotave: nga një minimum prej 114,5 % në fund të majit 1939 ka mbrrijt në fund të vjetit në një përqindje prej 201,4 % me një shumë të përgjithëshme prej Fr. sh. 53 miljonë. Asht një shumë kjo që duket e teprueme kundrejt nevojave të shndoshta të mbulesës, qoftë edhe sikur këto të konsiderohen në mëny-

rën ma të matun. E ky teprim mbuleset shifet edhe në rast se merren parasysh, kundrejt sajë, të gjitha detyrimet me skadim të shpejtë tue u a shtue biljetave në qarkullim: arrihet atëhere në një përqindje prej 83,9 %. Duhet marrë gjithashtu parasysh së depozitat e nalt-përmenduna të fondevet në të holla përbëjnë fuqinë për zgjanime të tjera në prodhimtarì e në lëvizje, shvillimet e të cilave do të mund të çojnë vetvetiu raportin midis qarkullimit. detyrimeve dhe mbulesës në nivele ma të barabartë.

Për sa shikon formimin e sajë, mbulesa asht regullue në konformitet me dispozitat e reja statutore të vendosuna n'Asamblén e qershorit 1939 në bazë të përcaktimeve të konvensjonit datë 20 prill 1939 që u përmend shumë herë ma sipër. Disponibilitetet n'ar kanë qëndrue në Fr. sh. 7,6 miljonë. Kusuri i mbulesës ka qenë përba prej disponibilitetesh në lira italiane për një kundërvleftë prej Fr. sh. 40,1 miljonë më 31 dhetuer 1939, nga të cilat Fr. sh. 4,9 miljonë përbajshin kredina në të pame mbi Banca d'Italia. Për të plotësuem



shumën e përgjithëshme prej Fr. sh. 53 miljonë që u përfill ma sipër kishim më 31 dhetuer 1939 Bona Thesari të Shtetit Italian, me skadencë jo ma tej se gjashtë muej, për një kundërvleftë prej 5,3 miljonë.

* * *

Përveç detyrës me regullue qarkullimin e mjeteve të pagesës, Banka, në vazhdim të detyrave të reja që i janë caktue qysh nga prilli i vjetit të kaluem, ka marrun përsipër atë të *regullimit të tregtìs së kambjove.* Detyrë kjo mjaft delikate që Banka ka pasun kujdesin me e shvillue në lidhje të vashdueshme me Administratat kompetente shqiptare dhe italiane. Një të tillë lidhje kemi qëllim që t'a bajmë përherë e ma të dendun: gjith kjo në armonì me vendimet e marruna në Fruerin e kaluem prej Komitetit mikst interqeveritar italo-shqiptar.

Përfundimet që kemi pasun në regullimin e kambjove mund të quhen të kënaqëshme në interesin e përgjithëshëm. Ato tregojnë në radhën e parë se si autonomija e valutës shqiptare nuk ka sjellë paragjykime por përkundrazi ka ba ma të lehtë kontrollin valutar ashtu edhe plotsimin e nevojave të divizës për veprimet me karakter të zakonshëm. Ky plotsìm ka mundun të arrihet pa përkufizime të mëdha për furnizime nga Jashtë ndërsa kanë qënë shtrì në Shqipnì clearing-et q'ekzistojshin midis Italìs dhe Vëndeve që vijojnë: Boemì-Moravì, Bullgarì, Gjermanì, Greqì, Jugoslavì, Portogalì, Rumanì, Slovakì

dhe Ungarì. Midis ktyne ishin furnizuesat ma të mdhaj të Shqipnìs, përveç Italìs natyrisht: Së bashku kishin kontribue në importimet e Shqipnìs, në vjetin 1938, me një përqindje prej 62,3 % kundrejt 37,7 % të sjelluna nga Vëndet e tjera me të cilat mbete ende në fuqì pagimi në divizë të lirë.

Me të vërtetë regullimi i kambjove nuk mund të mos sillte për Shqipnìn, ashtu si ndodh tashmà po thue për krejt Shtetet europjane, përkufizime në lëvizjet me jashtë të cilat duheshin me iu nënshtrue disiplinës së ré me anë lëshimi të lejeve t'importimit e t'eksportimit. Por me randsì shum ma të madhe ka qenë për ekonominë shqiptare përfitimi i rrjedhun nga regjimi i rì i kambjove, që ka formue një gja të vetme me krahasimin e frangut shqiptar lirës italiane mbi bazë të qëndrueshme të vendosun me kohë dhe të ripohueme nga Qeverìt e të dy Vëndeve në raportin e caktuem prej 1 me 6,25. Në këtë mënyrë lëvizja e të hollave midis Shqipnìs dhe Italìs ka mundun t'u shpëtojë përkufizimeve të kambjos që paraekzistojshin nga ana italiane, përkufizime të cilat në të shkuemen kanë pengue nganjëherë, për shkaqe valutare eprore, vuemjen në zbatim të inisjativave italiane për Shqipnìn, edhe pse të justifikueme nga arësye ekonomike. U krijue kështu çka qe mendue si e nevojshme për vuemjen në veprim të bashkimit doganuer italo-shqiptar: shkëmbimi i lirë i mallnave ndërmjet dy Vëndeve nuk mund të realizohesh pa trasmetimin e lirë në të holla të kun-

dërvleftës së mallnave të shkëbyeme. Po përveç kësajë u krijue mundësija për me transferue pa përkufizime kapitalet e mëdhaja italiane të sjelluna në Shqipnì, rrjedhja e të cilave ka formue – sikurse e kemi pà – elementin thelbësuer të ringjalljes së sotme të ekonomìs shqiptare.

Për të lehtësue këto *lëvizje të hollash ndërmjet Italìs dhe Shqipnìs,* edhe në pikëpamjen tekniko-bankare, janë marrun prej nesh masa të mjaftueshme, veçanërisht për sa i përket pagesave që kanë m'u krye në Shqipnì e që na janë mbështetë nga Thesari Mbretnuer Italian për llogarì të Shtetit. Jemi kujdesue gjithashtu m'u pajosë në Hënyrë të posaçme për pagesat që kanë m'u krye n'Italì, lavdì përkrahjes, mbi të gjitha, që na asht dhanë prej Banca d'Italia dhe marrëveshtjeve të harrijtuna me tre Institutet e mëdha italiane në interesin kombëtar: lidhet në këtë drejtim lëshimi i mandateve të Banca d'Italia dhe i çeqeve qarkulluesa të tre Instituteve të tjerë, shërbim ky që ka lehtësue shumë dërgesat e çdolloji të cilat kanë mbrrijt çifra të dukëshme.

Një tjetër fushë me randsì të veçantë në të cilën Banka asht ftue të veprojë asht ajo e *furnizimit të drithnave.* Sikurse u tha, pamjaftësija e drithnave, prej kohësh gja e regullshme kjo në Shqipnì, asht ndì në mënyrë të posaçme në vjetin vazhdues dhe ka shkaktue nevojën me importue sasìna të mëdha gruni e misri, Autoritetet kompetente kanë marrun mbi vehte kujdesin e po thua krejt furnizimeve në fjalë dhe kanë ngarkue Bankën t'onë që

të merrte në dorëzim ngarkesat e drithnave që mbrrijshin - tue marrë përsipër herë herë edhe financjimin përkatës - dhe të kryente ndamjen e këtyne drithnave e inkasimet përkatëse, gjithnjë simbas përcaktimeve të Autoriteteve në fjalë.

Në shvillimin e kësaj detyre e të tjerave të këtilla ka shërbye pajosja e *magazinave të përgjithëshme* t'ona të themelueme prej kohësh pranë Degave të ndryshme. Asht parashikue gjithashtu se duhet me procedue, në bashkëpunim me bankat e tjera që veprojnë në Shqipnì, në krijimin e magazinave të përgjithëshme të reja e të mjaftueshme në Durrës, të cilat do të shërbejnë me plotësue çka duhet për atë liman ku përqëndrohen lëvizjet detare të Shqipnìs.

* * *

Kjo veprimtarì e përzieme, që i drejtohet mbi të gjitha interesit publik, nuk ka shmangun Bankën t'onë së kujdesuni për shërbimet e zakonëshme bankare, edhe në interes të klientelës së zakonëshme e me konsideratë të posaçme për firmat tregëtare. Shumat e *llogarive të klientelës së zakonëshme* janë ma se dyfishue, tue kalue nga Fr. sh. 3,9 miljonë më 31-12-1938 në Fr. sh. 8,7 miljonë më 31-12-1939. Kësaj sthese mandej i korrespondon një zbritje e lehtë në shumën e përgjithëshme të *depozitave të kursimit* që brënda perjudhës së naltpërmendun kanë kalue nga Fr. sh. 1,7 miljonë në Fr. sh. 1,4 miljonë

megjithse numri i librezave të kursimit asht shtue nga 1428 në 1623. Veçanërisht e shqueme ka qenë shtesa e depozitave në *llogarìt e Bankave dhe enteve financjare* e mbi të gjitha *në llogarit' e enteve publike*: shuma e përbashkët e këtyne ka kalue nga një teprícë prej Fr. sh. 6,1 miljonë më 31-12-1938 në Fr. sh. 32,1 miljonë më 31-12-1939. E konsiderueshme asht edhe sthesa e *çeqevet në qarkullim*, teprica e të cilëve ka kalue nga Fr. sh. 537 mijë më 31-12-1938 në Fr. sh. 2.580 mijë më 31-12-1939.



Gjithsejt shuma e përbashkët e këtyne depozitave e çeqeve kish mbrrijtë në fund të vjetit 1939 në Fr. sh. 44,7 miljonë. Tue shtue disponibilitetet e krijueme për qarkullimin e bankonotave e për të tjera shkaqe ashtu edhe fondet patrimoniale që i përkasin kapitalit dhe rizervave i asht mbrrijt më 31 dhetuer 1939 njëj disponibiliteti të përgjithshëm prej Fr. sh. 82,5 miljonë (që i korrespondojnë ma se gjysë miljardi lirash), kundrejt Fr. sh. 32,4 miljonë (baras me afro 200 miljonë lira) më 31-12-1938. Në kto çifra pasqyrohet sintetikisht shvillimi që ka marrun Banka gjatë vjetit 1939.

BKSH

Vendosjet e të hollave në *veprime kredije* nuk kanë pasun një ecje paralele me atë të disponibiliteteve. Ato gjatë vjetit 1939 janë shtue vetëm 27,9 %. E pikërisht kredinat me klientelën e zakonëshme kanë kalue nga Fr. sh. 6,0 miljone në Fr. sh. 7,2 miljone, dhe tepricat aktive kundrejt Bankash, Entesh financjare dhe Entesh publike kanë kalue nga Fr. sh. 167 mijë në Fr. sh. 646 mije.

Kjo ecje ka lidhje me sa u tha ma naltë reth shumimit të mjeteve në të holla që u derdhnë nga Italia në Shqipni. Në mënyrë të veçantë vendosja e lehtë e mallnave dhe e sendeve iu ka dhanë tek e para disponibilitete të gjana të hollash të gjitha firmave, aqë sa kredinat e bame klientelës së zakonëshme kishin zbritun nga Fr. sh. 6 miljonë më 31-12-1938 në Fr. sh. 5,6 miljonë më 31-7-1939. Prej atëherë ka nisun ndërmarrja, e lidhun ngushtë me shtrimjen e lëvizjevet me Italinë e me Vëndet e jashtme dhe me transaksjonet tregtare me aktive brënda në vënd, ndërmarrje që vashdon edhe sot të jetë në shvillim e sipër. Kanë kontribue në këtë edhe lehtësinat e veçanta të bamuna në favorin e Sipërmarrjeve eksekutive të veprave botore, me anë formash të posaçme financjimesh me afat të shkurtër.

Kjo ecje e disponibiliteteve dhe e vendosjeve ka lejue një zbritje në *taksin zyrtar të skontos* (kamatës) që qysh prej 1-IV-1937 kish mbetun i pandryshuem në 6 %. Tue zanë fill nga 21 mars i kaluem ai asht zbritë në 5½ %, masë kjo që do të mund të favorizojë një përhapje ma të madhe të kredive të Bankës, për të mirën e prodhimtaris dhe të lëvizjeve.

Sa për veprimet e tjera që, në të vërtetën, nuk janë pa randësì, asht për t'u përmendë veçanërisht shvillimi që ka pasun *shërbimi i inkasimeve,* në mënyrë të veçantë për dërgesat dokumentare, të cilat, nga një mesatare muejore prej 1.574 më 1938 kanë kalue në afro 3.000 në gjashtëmuejorin e dytë të vjetit 1939. Lidhet me këtë shërbim ay i të ashtuquejtunave *ndërmjetësì tregtare,* nëpërmjet të cilit Banka ka kontribue në lidhjen e raporteve të reja marrëdhanjesh midis firmash tregtare italiane e shqiptare.

Gjatë vjetit asht çilun një *agjencì e rè në Elbasan* e mvarun drejt për drejt prej Selìs së Tiranës tue u ba kështu nandë tregjet që shërbehen direkt nga Degat t'ona. Asht lypë gjithashtu me riforcue e me shtrì dal nga dalë strukturën e Degavet të themelueme prej kohësh e në mënyrë të posaçme Selìt e Tiranës e të Durrsit.

Këtyne nevojave iu asht ba ballë tue marrun në shërbim Personel të rì: bajshin pjesë në Bankë në fundin e vjetit 235 veta (e pikërisht 13 drejtora, 15 Funksjonarë të tjerë, 23 nëpunësa të cilësuem, 147 nëpunësa të pacilsuem, 37 shërbtorë) kundrejt 148 vetave që ishin në fund të vjetit të maparëshëm.

Por ma tepër se çdo gjaje asht mundun me iudalë në krye detyrave të reja e me i bà ballë grumbullit të madh të punës në mbështetje të gjallnìs me të vërtet të jashtzakonëshme me të cilën i tanë Personeli, e në radhë të parë drejtuesat, janë sakrifikue në çdo kohë me ndjenjën e naltë të detyrës. Atyne iu drejtohet lëvdata ma e nxehtë.

Shpenzimet dhe randimet e gjestjonit janë shtue në mënyrë të ndiëshme tue mbrrijtun në një shumë të përgjithëshme prej Fr. sh. 1.195.712,52 (kundrejt Fr. sh. 999.085,57 më 1938). Në këtë shumë nuk pasqyrohen ende shtesat e shpërblimeve që qemë të detyruem me ba nga fundi i ushtrimit për shkak të ngrijtjes së çmimeve të jetesës gjithë Personelit banues në Shqipni. Fitimet kanë shënue edhe ato një shtesë të kënaqëshme tue mbrrijt në Fr. sh. 1.519.385,82 (kundrejt Fr. sh. 1.303.135,46 më 1938). Teprica aktive paraqet pra një përmirësim, me gjith se të lehtë, kundrejt vjetit të maparëshëm, me një shumë prej Fr. sh. 323.673,30 që propozojmë të ndahet si vijon:

Fitime të thjeshta të vërtetueme në Bilanç		Fr. sh. 323.673,30
Qeverìs Shqiptare 10%	Fr. sh. 32.367,33	
Rezervës 10%	» 32.367,33	» 64.734,66
		Fr. sh. 258.938,64
Bartje e fitimeve t'ushtrimit t'maparshëm		» 133.952,03
		Fr. sh. 392.890,67
Aksjonistave (4% mbi kapitalin e derdhun)	Fr. sh. 153.500.—	
Komitetit dhe Këshillit (5% + 5%)	» 25.893,86	
Personelit (10%)	» 25.893,86	
Rezervës (për me plotsue Fr. sh. 750.000)	» 67.632.67	» 272.920,39
Mbetje për t'u bartë në të ré		Fr. sh. 119.970,28

RKSH

Do të shifni se mbetet i pandryshuem dividendi mbi aksjonet, ndërsa vijnë m'u shtue shumat e caktueme për rezervën e zakonëshme (Fr. sh. 100.000 kundrejt Fr. sh. 50 mijë të ushtrimevet të maparëshëm).

* * *

Me sa Ju parashtruem, veç pasqyrimit të përpjekjeve të vjetit 1939, kemi pasun qëllim gjithashtu me vizatue vijën e veprimit t'onë për t'ardhmen. Jini të sigurt se ajo ka m'u frymëzue nga qëllimi i patundëshëm për me e ba Institutin t'onë gjithnjë ma të fuqishëm dhe efiçient në çdo sektor që rrjedh prej tij për të mundun të kontribuojë, në çdo kohë e në çfarëdo rethanë, në fatet e sigurta të ekonomìs shqiptare, e thirun tashmà me rithm të shpeshtë për t'u vu në radhë e për të përparuem në sferën ma të gjanë të ekonomìs italiane.

BKSH

BKSTY

PASQYRA STATISTIKE

BKSH

BKSH

QARKULLIM I BANKANOTAVE

PROSPEKT I. (në mijra Fr. A.)

DATA	100 Fr. A.	20 Fr. A.	5 Fr. A.	5 Lek = 1 Fr. A.	Shuma e Përgjithëshme
31 Dhetuer 1929	2.904	7.224	1.404	4	11.536
» » 1930	3.904	7.263	1.755	3	12.925
» » 1931	4.012	6.029	1.825	3	11.869
» » 1932	4.785	6.269	1.995	3	13.052
» » 1933	4.786	5.722	1.654	3	12.165
» » 1934	4.120	5.085	1.811	3	11.019
» » 1935	4.269	5.856	2.115	3	12.243
» » 1936	3.507	5.274	1.869	3	10.653
» » 1937	3.699	5.294	2.135	3	11.131
» » 1938	3.830	4.462	2.234	3	10.529
31 Kallnuer 1939	3.985	4.506	2.235	3	10.729
28 Fruer »	4.303	4.576	2.157	3	11.039
31 Mars »	4.837	4.913	2.186	3	11.939
30 Prill »	6.920	6.982	3.357	3	17.262
31 Maj »	4.910	9.467	4.712	3	19.092
30 Qershuer »	5.240	10.092	5.381	3	20.716
31 Korrik »	5.854	10.932	5.627	3	22.416
31 Gusht »	7.044	11.973	6.014	3	25.034
30 Shtatuer »	7.815	11.829	6.600	3	26.247
31 Tetuer »	8.325	12.064	7.023	3	27.415
30 Nanduer »	8.419	11.953	7.095	3	27.470
31 Dhetuer »	8.093	11.558	6.662	3	26.316

MBULESA E QARKULLIMIT

PROSPEKT II. (në mijra Fr. A.)

DATA	Ar	Disponibilitete të thjeshta në Lira Italiane (1)	Bona Thesari në Lira Italiane	Shuma e Përgjithëshme
31 Dhetuer 1929	1.760	17.256	—	19.016
» » 1930	1.933	20.468	—	22.401
» » 1931	5.038	15.412	—	20.450
» » 1932	5.407	18.755	—	24.162
» » 1933	7.225	13.827	—	21.052
» » 1934	7.122	11.299	—	18.421
» » 1935	7.556	11.515	—	19.071
» » 1936	7.556	16.255	—	23.811
» » 1937	7.583	12.576	2.412	22.571
» » 1938	7.574	8.912	2.408	18.894
31 Kallnuer 1939	7.574	8.335	2.409	18.318
28 Fruer »	7.574	8.305	2.410	18.289
31 Mars »	7.573	8.465	2.410	18.448
30 Prill »	7.568	11.795	2.400	21.763
31 Maj »	7.568	11.897	2.400	21.865
30 Qershuer »	7.568	13.334	4.800	25.702
31 Korrik »	7.567	19.546	4.800	31.913
31 Gusht »	7.567	24.240	4.800	36.607
30 Shtatuer »	7.567	33.784	4.800	46.151
31 Tetuer »	7.567	34.234	4.800	46.601
30 Nanduer »	7.567	36.089	4.800	48.456
31 Dhetuer »	7.567	40.149	5.280	52.996

(1) - Deri më 31 Maj 1939, tue u përshi disponibilitetet n'argjend e në diviza të hueja (detyrimet të përjashtueme).

MONEDHA DIVIZIONALE TË EMETUEME

PROSPEKT III. (në mijra Fr. A.)

DATA			Argjend		Nikel - Akmonital				Priç		Shuma e Përgjithëshme
			10 Lek = 2 Fr. A.	5 Lek = 1 Fr. A.	2 Lek = 0,40 Fr. A.	1 Lek = 0,20 Fr.A.	0,50 Lek = 0,10 Fr.A.	0,25 Lek = 0,05 Fr.A.	0,10 Lek = 0,02 Fr.A.	0,05 Lek = 0,01 Fr.A.	
31 Dhetuer	1929		—	—	—	295	95	61	—	—	451
» »	1930		—	—	—	477	130	63	—	—	670
» »	1931		—	—	—	552	150	63	—	—	765
» »	1932		—	—	—	693	180	61	—	—	934
» »	1933		—	—	—	660	175	58	—	—	893
» »	1934		—	—	—	739	195	59	—	—	993
» »	1935		208	382	—	721	191	62	2	1	1.567
» »	1936		223	588	—	582	156	59	2	1	1.611
» »	1937		300	792	—	606	154	60	2	2	1.916
» »	1938		277	939	—	528	146	63	3	2	1.958
31 Kallnuer	1939		268	935	—	518	146	62	2	3	1.934
28 Fruer	»		252	903	—	503	144	62	2	3	1.869
31 Mars	»		245	891	—	492	142	62	2	3	1.837
30 Prill	»		286	1.054	—	528	154	62	2	3	2.089
31 Maj	»		303	1.222	—	579	172	63	3	3	2.345
30 Qershuer	»		322	1.287	—	624	180	63	3	4	2.483
31 Korrik	»		332	1.325	—	678	187	63	4	4	2.593
31 Gusht	»		339	1.420	—	718	193	63	4	4	2.741
30 Shtatuer	»		384	1.595	—	740	196	63	5	4	2.987
31 Tetuer	»		419	1.796	—	745	198	63	6	5	3.232
30 Nanduer	»		428	1.974	—	742	198	63	7	6	3.418
31 Dhetuer	»		461	2.030	8	737	198	63	8	6	3.511

KUOTIME TE KAMBIOVE

PROSPEKT IV. (Në perqindje të pariteteve « të vjetra »)

KOHA		Lit.	Fr. Sv.	Fr. Fr.	$	Lst.
31 Dhetuer	1929	100,03	101,34	—	100,53	101,02
» »	1930	99,61	100,92	—	100,06	100,13
» »	1931	96,60	101,35	—	99,76	71,64
» »	1932	97,09	99,96	99,93	99,87	68,19
» »	1933	100,85	101,30	101,06	64,64	68,—
» »	1934	97,08	100,34	100,61	59,72	60,74
» »	1935	90,74	100,40	100,61	59,43	60,27
» »	1936	58,95	70,28	70,33	58,95	59,55
» »	1937	59,—	70,72	51,09	58 89	60,59
» »	1938	58,88	69,37	39,84	59,04	56,62
Kallnuer	1939	58,91	69,36	39,89	59,13	56,86
Fruer	»	58,91	69,66	40,09	59,24	57 09
Mars	»	58,91	69,60	40,11	59,24	57,13
Prill	»	58,80	68,88	39,99	59,13	56,93
Maj	»	58,66	68,82	39,93	59,03	56,78
Qershuer	»	58,66	68,76	39,78	58,82	56,62
Korrik	»	58,66	68,58	39,68	58,66	56,46
Gusht	»	58,66	68,70	39,24	58,68	55,75
Shtatuer	»	58,66	70,19	34,90	59,73	49,60
Tetuer	»	58,66	71,15	35,50	61,13	50,43
Nanduer	»	58,66	71,11	34,76	61,13	49,28
Dhetuer	»	58,66	71,09	34,77	61,13	49,36

DEPOZITA TË KLIENTELËS SË ZAKONSHME
NË KURSIM DHE NË KONT KORENT

PROSPEKT V.

DATA	Depozita kursimi				Depozita në kont korent			
	Numri	Shuma			Numri	Shuma		
		në Fr. A.	në Lira Italiane	Shuma		në Fr. A.	në Lira Italiane e në valuta të tjera	Shuma
		(në mijra Fr. A.)				(në mijra Fr. A.)		
31 Dhetuer 1929	374	605	183	788	671*	1.704	940*	2.644*
» » 1930	555	939	298	1.237	730*	2.791	994*	3.785*
» » 1931	646	651	288	939	824*	2.267	1.523*	3.790*
» » 1932	790	870	255	1.125	886*	2.305	1.195*	3.500*
» » 1933	788	896	139	1.035	796*	2.241	957*	3.198*
» » 1934	744	846	66	912	717	2 032	502	2.534
» » 1935	932	1.116	39	1.155	722	2.992	641	3.633
» » 1936	1.020	1.084	65	1.149	698	3.292	645	3.937
» » 1937	1.191	1.390	20	1.410	737	3.793	510	4.303
» » 1938	1.428	1.641	11	1.652	852	3.318	587	3.905
31 Kallnuer 1939	1.443	1.661	11	1.672	854	3.312	690	4.002
28 Fruer »	1.448	1.645	12	1.657	857	7.396	833	4.229
31 Mars »	1.438	1.597	12	1.609	857	3.278	815	4.093
30 Prill »	1.325	1.193	13	1.206	766	3.313	411	3.724
31 Maj »	1.335	1.198	27	1.225	848	4.228	439	4.667
30 Qershuer »	1.155	1.415	27	1.442	964	4.820	255	5.075
31 Korrik »	1.188	1.434	40	1.474	964	5.237	332	5.569
31 Gusht »	1.446	1.429	53	1.482	973	5.266	432	5.698
30 Shtatuer »	1.471	1.508	59	1.567	988	5.590	378	5.968
31 Tetuer »	1.482	1.240	82	1.322	1.027	6.745	419	7.164
30 Nanduer »	1.584	1.147	185	1.332	1.022	6.145	1.019	7.164
31 Dhetuer »	1.623	1.144	233	1.377	1.062	6.929	1.747	8.676

* Të dhana rektifikuëme (përveç depozitavet prej ari edhe argjendi të mbajtuna si garancië të paradhanjeve.

TË TJERA DEPOZITA NË KONT KORENT DHE NË ÇEKE

PROSPEKT VI. (në mijra Fr. A.)

DATA	Depozita të Entevet Publike, Banka dhe Ente Financjare			Çeke në qarkullim		
	në Fr. A.	në Lira Italiane e në valuta të tjera	Shuma	në Fr. A.	në Lira Italiane e në valuta të tjera	Shuma
31 Dhetuer 1929 . .	4.771	169	4.940	195	31	226
» » 1930 . .	6.885	157	7.042	351	17	368
» » 1931 . .	8.787	2.118	10.905	391	70	461
» » 1932 . .	10.712	5.099	15.811	302	37	339
» » 1933 . .	6.565	5.409	11.974	257	24	281
» » 1934 . .	4.847	4.849	9.696	223	7	230
» » 1935 . .	2.899	1.587	4.486	271	12	283
» » 1936 . .	11.230	647	11.877	372	17	389
» » 1937 . .	8.225	342	8.567	515	15	530
» » 1938 . .	5.809	252	6.061	522	15	537
31 Kallnuer 1939 . .	5.153	533	5.686	564	13	577
28 Fruer » . .	4.708	365	5.073	507	12	519
31 Mars » . .	4.619	414	5.033	599	14	613
30 Prill » . .	4.274	406	4.680	667	15	682
31 Maj » . .	4.069	557	4.626	987	19	1.006
30 Qershuer » . .	4.385	419	4.804	1.424	15	1.439
31 Korrik » . .	8.436	431	8.867	2.593	19	2.612
31 Gusht » . .	11.190	1.000	12.190	2.286	23	2.309
30 Shtatuer » . .	18.955	3.685	22.640	2.340	21	2.361
31 Tetuer » . .	19.757	3.796	23.557	2.451	22	2.473
30 Nanduer » . .	23.251	4.192	27.443	2.130	26	2.156
31 Dhetuer » . .	26.230	5.865	32.095	2.554	26	2.580

VEPRIME KREDITI

PROSPEKT VII. (në mijra Fr. A.)

DATA	Kredina të Klienteles së zakonëshme				Kredina të tjera	Shuma e Përgjithëshme
	Skontime dhe paradhanje të garantueme	Skontime tregtare dhe financiare	Kredina në kont korent	Shuma e Përgjithëshme		
31 Dhetuer 1929	1.468	1.397	398	3.263	1.795	5.058
» » 1930	1.503	1.935	341	3.779	2.573	6.352
» » 1931	1.648	2.877	444	4.969	2.062	7.031
» » 1932	1.064	2.375	397	3.836	1.890	5.726
» » 1933	758	2.200	353	3.311	7	3.318
» » 1934	533	2.191	286	3.010	16	3.026
» » 1935	675	2.532	564	3.771	1	3.772
» » 1936	1.198	2.620	401	4.219	153	4.372
» » 1937	1.138	2.957	561	4.656	154	4.810
» » 1938	1.647	3.673	651	5.971	167	6.138
31 Kallnuer 1939	1.597	3.649	810	6.056	271	6.327
28 Fruer »	1.581	3.617	721	5.919	345	6.264
31 Mars »	1.665	3.719	842	6.226	818	7.044
30 Prill »	1.434	3.564	1.030	6.028	3.952	9.980
31 Maj »	1.567	3.452	1.212	6.231	5.532	11.763
30 Qershuer »	1.366	3.319	1.056	5.741	1.389	7.130
31 Korrik »	1.403	3.142	1.029	5.574	1.835	7.409
31 Gusht »	2.225	3.018	847	6.090	1.457	7.547
30 Shtatuer »	2.423	2.957	992	6.372	2.039	8.411
31 Tetuer »	2.580	3.346	1.404	7.330	2.790	10.120
30 Nanduer »	3.120	3.017	1.870	8.007	1.861	9.868
31 Dhetuer »	2.181	3.157	1.867	2.205	646	7.851

NUMRAT TREGUESE TË ÇMIMEVE ME SHUMICË

Bazë: Mesatarja 1927 = 100

PROSPEKT VIII.

MUEJT	1937		1938		1939	
	Indeks i gjanave ushqimore	Indeks i përgjithëshme	Indeks i gjanave ushqimore	Indeks i përgjithëshme	Indeks i gjanave ushqimore	Indeks i përgjithëshme
Kallnuer	53.03	64.10	53.87	66.20	53.61	62.84
Fruer	54.31	65.25	54.41	65.73	53.55	62.47
Mars	53.09	65.71	52.47	63.57	53.05	62.37
Prill	53.37	65.96	54.32	64.86	57.29	65.61
Maj	53.62	64.70	54.60	64.90	56.59	65.82
Qershuer	51.94	63.14	52.81	61.57	55.28	64.95
Korrik	52.04	63.68	52.63	62.08	56.65	66.74
Gusht	52.04	63.75	52.74	62.41	63.13	72.31
Shtatuer	52.25	64.65	52.21	62.75	58.73	69.47
Tetuer	51.90	65.90	52.36	62.69	62.80	73.37
Nanduer	51.69	65.68	53.39	63.07	67.76	77.83
Dhetuer	53.75	66.76	52.73	62.81	72.17	83.70
Mesatare vjetore	52.75	64.94	53.21	63.55	59.22	68.96

BKSh

BILANÇI I SHTETIT
TE HYEME
(në mijra Fr. A.)

PROSPEKT IX.

VJETI	T' ardhuna prej pasunis së Shtetit	Tatime të drejta dhe taksa				Tatime indirekte mbi konsum		Monopole	Të ardhuna prej shërbimit botuer	Të tjera të hyeme	Shuma e përgjithëshme e të hyemeve
		Ndërtesa	Të dheta mbi produkte bujqësore	Xhelep	Të tjera tatime dhe taksa	Dogana dhe të drejta detare të ndryshme	Alkol, duhan sheqer, kafe dhe mjell				
1929-30 1)	1.170	1.273	4.844	2.476	2.230	9.128	3.496	4.224	963	996	30.800
1930-31 1)	1.057	1.301	3.281	2.413	2.613	8.785	3.194	5.238	1.332	604	29.818
1931-32 1)	963	1.057	3.290	2.527	2.822	9.415	3.205	4.923	1.075	3.443	32.720
1932-33 1)	980	1.708	2.807	2.300	2.221	7.638	2.913	4.732	1.052	10.983	37.334
1933-34 1)	831	1.323	1.538	1.358	2.115	5.730	2.487	4.482	845	3.409	24.118
1934-35 2)	550	600	1.500	1.100	1.600	5.040	2.690	3.960	770	697	18.507
1935-36 2)	475	450	800	1.000	1.530	5.000	2.375	3.610	1.200	797	17.237
1936-37 2)	690	500	1.000	1.200	1.263	6.100	2.540	3.720	840	731	18.584
1937-38 2)	1.745	400	850	1.200	2.144	6.200	2.677	3.715	900	6.394	26.225
1938-39 2)	2.140	500	1.000	1.449	2.535	7.668	2.952	3.770	992	5.229	28.235
1939-40 2) 3)	860	500	1.000	1.207	1.470	18.170	3.610	3.510	1.150	8.523	40.000

SPENZIME
(në mijra Fr. A.)

PROSPEKT X.

VJETI	MINISTRIT								Shuma e përgjithëshme e spenzimeve
	Financa	Drejtësia	E mbrendëshme	Arsimi	E jashtme	PP. Botore	Ekonomia Kombëtare	Mbrojtja Kombëtare	
1929-30 1)	4.898	1.309	3.202	3.638	976	2.502	1.197	15.403	33.125
1930-31 1)	5.502	1.206	2.428	3.569	849	2.504	1.232	14.365	31.655
1931-32 1)	6.224	1.208	2.574	4.123	903	3.605	1.988	14.886	35.511
1932-33 1)	4.758	1.218	3.153	4.598	850	6.248	2.650	14.224	37.699
1933-34 1)	4.059	985	2.466	3.113	696	1.698	673	9.985	23.672
1934-35 2)	3.529	793	1.588	3.013	482	1.221	448	7.814	18.888
1935-36 2)	3.640	815	1.448	2.878	447	1.413	643	6.751	18.035
1936-37 2)	3.656	838	1.524	3.053	678	1.667	713	6.750	18.879
1937-38 2)	5.832	876	1.853	3.093	695	1.653	2.573	9.650	26.225
1938-39 2)	5.621	947	3.411	3.728	700	1.959	2.565	9.634	28.565
1939-40 2) 3)	15.492	2.045	5.838	5.823	165	5.259	4.000	1.378	40.000

(1) Shkoqitje llogarinash mbi konsuntivin — (2) Bilanci preventiv. — (3) Tue zanë fill prej 1939/40 ushtrimi financjar merr fund më 30 qershuer në vënd të 31 marsit: per ushtrimin në fjalë pra kemi nje afat prej 15 muejsh (prej 1-IV-1939 deri më 30-IV-1940).

BKSH

RELACION I SINDIKËVE

BKSH

BKSH

Shokè Aksjonista

Bilançi patrimonial dhe Nxjerja e llogaris ekonomike të Bankës Kombëtare të Shqipnìs më 31 Dhetuer 1939, XVIII, që po Ju paraqiten për aprovim prej Këshillit t'Administratës, janë shqyrtue hollësisht në çdo pikë prej Kolegjit të Syndikve, i cili mund t'Ju sigurojë se përfundimet e pasqyrueme në 'to janë krejt konforme me faktet administrative dhe me regjistrimet llogaritare, qofshin analitike ose sintetike, dhe u korespondojnë pikërisht gjëndjeve aktive e pasive të Shoqnìs.

Kto përfundime përmblidhen në çka vijon:

Aktiv (tue u përshì llogarìt'e rendëshme)	Fr. A.	136.151.222,71
Pasiv (tue u përshì llogarìt'e rendëshme)	»	135.827.549,41
Fitime të thjeshta t'ushtrimit	Fr. A.	323.673,30
T'ardhuna e fitime	Fr. A.	2.049.078,85
Shpenzime, amortizimē e humbje .	»	1.725.405,55
Kthejnë fitimet e thjeshta t'ushtrimit në	Fr. A.	323.673,30

BKSH

Sasija e këtyne çifrave, e krahasueme me ato të gjestjoneve të kaluem, do të mjaftonte në vetvehte me paraqitë një tregim kuptimplotë, me gjith se të përmbledhun, të shvillimit q'asht vërtetue në shërbimet e në lëvizjet bankare — e ma pikërisht në disa prej tyne — nga njeni vjet në tjetrin mbas ndodhinave historike, të cilat, tue bashkue fatet e Kombit fisnik Shqiptar me ato të Perandoris Fashiste, kanë dhanë rastin edhe Institutit t'Uej, me gjith se pa ndryshue strukturën dhe qëllimet e tij tradisjonalë, të përhapë e të dendësojë veprimtarìn'e vetë dhe të marrë gjithashtu përsipër detyra të tjera të randësishme për të kontribue që të bahet gjithnjë ma i leht'e i frytshëm bashkëpunimi midis dy popujve.

Ka nisun kështu në jetën e Institutit t'Uej një faz'e rè, e gjallë në punë dhe e pasun në prospektiva; e relacjoni, si përherë i kthjellt e përfundues që i Ndershmi Këshill i Administratës Ju ka bamun, shkarkon Kolegjin e Syndikve nga çdo shpjegim tjetër reth veprimtaris së shvillueme e reth vështirësive të ndeshuna deri më sot.

Një homazh të detyrshëm pra Kolegji i Syndikve dëshiron me i kushtue të shkëlqyeshmit Kryetar dhe Këshilltarit të Deleguem e Drejtorit të Përgjithëshëm për drejtimet larg-gjykuese e për veprimin e kujdesëshëm me të cilat kanë prì përpara vendimtarisht Institutin në rrugën e realizimeve të reja, për përpiknìn në

regullin e rì të sendeve e për perfeksjonin e thurjevet bankare; ndërsa një lëvdat'e nxehtë i bahet krejt Personelit për veprën e palodhëshme e për zotësìn që ka tregue.

Kolegji i Syndikve Ju propozon pra t'aprovoni bilançin patrimonial dhe Nxjerjen e Llogarìs Ekonomike më Dhetuer 1939, XVIII, ashtu edhe ndamjen e fitimevet të thjeshta t'ushtrimit, sikurse Ju parashtrohen nga i Ndershmi Këshill i Administratës.

BKSH

BKSH

GJINDJET MUEJORE

BKSH

BKSH

GJINDJET

(në franga

Muejt		AKTIF									
		Aksionista llogari kapital	Ar	Disponibilitete në Lira Italiane b)	Bona të Thesarit e Tituj Shteti italianë	Skontime	Paradhanje	Llogari rrjedhëse aktive	Efekta për inkasim	Debitorë për dorëzani	Të tjera zana të aktivit
Dhetuer	1929	8.662.500 —	a) 1.858.612,95	18.524.988,12	—	1.781.712,64	1.070.859,65	2.163.206,31	1.062.388,70	1.306.035,55	70.152.285,41
»	1930	8.662.500 —	a) 1.977.706,38	21.931.312,86	5.303.703,11	2.316.659,45	1.122.065,45	2.913.336,13	1.049.386,69	1.771.635,39	68.535.324,44
»	1931	8.662.500 —	a) 5.344.222,15	19.408.495,27	5.540.746,83	3.205.642,64	1.325.973,93	2.506.060,39	2.434.502,71	1.654.667,65	60.811.611,72
»	1932	8.662.500 —	a) 5.545.836,48	25.339.097,08	5.981.165,17	2.659.909,85	778.901,45	2.287.385,35	2.391.469,49	1.758.871,94	55.297.982,51
»	1933	8.662.500 —	a) 7.394.359,10	20.353.671,48	6.067.706,08	2.485.952,43	472.656,85	359.413,56	1.442 224,69	1.646.726,21	23.002.737,46
»	1934	8.662.500 —	a) 7.125.126,25	16.720.609,45	5.908.429,10	2.210.751,03	512.533,24	302.335,92	977.208,23	1.245.094,20	22.095.903,57
»	1935	8.662.500 —	7.556.320,46	13.793.709,69	3.910.818,68	2.543.028,43	664.102,82	564.725,66	1.522.314,16	1.201.222,05	21.497.973,59
»	1936	8.662.500 —	7.555.740,46	17.629.620,69	6.930.599,40	2.646.416,10	1.171.442,70	554.052,62	1.211.916,56	1.208.489,05	19.896.105,83
»	1937	8.662 500 —	7.582.770,46	13.462.755,30	9.025 980,54	2.969.847,25	1.124.456,40	715.414,15	1.471.693,05	1.617.862,22	26.869.209,91
»	1938	8.662.500 —	7.574.460,46	9.777.423,62	8.542 824,99	3.693.643,83	1.626 711,94	817.512,83	1.849.296,77	1.670.161,25	26.796.624,80
Kallnuer	1939	8.662.500 —	7.574.000,46	9.582.596,27	8.466.024,99	3.689.717,40	1.555.829,92	1.081.451,22	1.709.748,19	1.660.356,25	25.976.449,07
Fruer	»	8.662 500 —	7.574.200,46	9.527.904,18	8.467.749,99	3.677.097,37	1.520.882,01	1.066.049,05	1.738.260,64	1.667.764,05	26.553.545,18
Mars	»	8.662.500 —	7.573.180,46	9.719.990,28	8.467.749,99	3.791.185,01	1 578.191,73	1.674.962,44	1.663.679,13	1.691.682,95	26.351.759,32
Prill	»	8.662.500 —	7.568.070,46	12.639.843,04	8.431.941,15	3.636.837,48	1.313.947,79	5.029.069,42	1.545.077,56	1.684.575,55	28.166.753,99
Maj	»	8.662.500 —	7.567.590,46	12.938.824,27	8.426.205,22	3.502.940,42	1.426.447,05	6.833.981,21	1.448.312,67	1.667.192,60	25.690.841,27
Qershuer	»	8.662.500 —	7.567.560,46	13.869.345,16	12.986.205,22	3.347.449,24	1.207.398,53	2.574.982,04	1.717.491,46	1.720.918,05	28.975.928,17
Korrik	»	8.662.500 —	7.567.560,46	20.167.491,89	13.466.205,22	3.162.196,60	1.230.527,88	3.016.313,56	1.610.581,95	1.737.205,75	31.325.967,30
Gusht	»	8.662.500 —	7.567.200,46	25.584.431,72	13.946.205,25	3.026.946,14	1.937.782,42	2.582.186,92	1.522.985,64	1.692.045,95	33.275.761,77
Shtatuer	»	8.662.500 —	7.567.200,46	37.762.914,02	14.868.571,75	2.966.490,61	2.139.199,65	3.305.844,98	1 751.699,25	1.997.633,70	32.896.614,74
Tetuer	»	8.662.500 —	7.567.140,46	38.365.454,84	15.668.571,75	3.356.962,70	2.882.071,92	3.880.569,65	2.172.816,22	2.021.701,33	37.249.001,99
Nanduer	»	8.662.500 —	7.567.060,46	41.317.022,92	16.468.571,75	3.025.240,76	3.234.678,69	3.607.813,77	1.892.903,60	2.036.798,94	38.955.119,63
Dhetuer	»	8.662.500 —	7.567 060,46	47.805.455,61	17.133.872,45	3.181.750,96	2.128,888,45	2.540.205,99	1.874.208,65	1.270.494,65	45.158.092,90

a) Përmban të mbetunat prej argjendi në kasë (maksimumi i shumës: Fr. A. 250.186,78 më 31-XII-1931).
b) Deri më 31 maj 1939, tue u pershi llogaritë në diviza të tjera.

MUEJORE

shqiptare)

PASIV								
Kapital Shoqnuer	Rezervë	Bileta në qarkullim	Detyrime me afat të përnjihershëm		Kreditorë për efekte për inkasim	Dorëzani për llogari personash të tretë	Të tjera zana të pasivit	SHUMA E PËRGJITHËSHME
			në Fr. A.	në Lira Italiane b)				
12.500.000 —	150.000 —	11.535.899 —	7.275.396,44	1.368.019,78	1.062.388,70	1.306.035,55	71.384.849,86	106.582.589,33
12.500.000 —	200.000 —	12.925.370 —	10.966.087,09	1.508.230,35	1.049.386,69	1.771.635,39	74.662.920,38	115.583.629,90
12.500.000 —	250.000 —	11.868.589 —	12.095.816,03	4.302.899,91	2.434.502,71	1.654.667,65	65.787.947,99	110.894.423,29
12.500.000 —	300.000 —	13.052.371 —	14.188.904,36	6.723.338,19	2.391.469,49	1.758.871,94	59.788.164,34	110.703.119,32
12.500.000 —	350.000 —	12.164.662 —	9.958.590,39	6.695.189,22	1.442.224,69	1.646.726,21	27.130.555,35	71.887.947,86
12.500.000 —	400.000 —	11.019.258 —	7.947.862,99	5.424.135,84	977.208,23	1.245.094,20	26.246.931,73	65.760.490,99
12.500.000 —	450.000 —	12.242.956 —	7.278.069,06	2.278.863,89	1.522.314,16	1.201.222,05	24.443.290,38	61.916.715,54
12.500.000 —	500.000 —	10.652 843 —	15.977.934,47	1.374.436,99	1.211.916,56	1.208.489,05	24.041.263,34	67.466.883,41
12.500.000 —	550 000 —	11.131.266 —	13 923.178,43	886.506,28	1.471 693,05	1 617.862,22	31.421.983,30	73.502.489,28
12.500.000 —	600.000 —	10.528.677 —	11.289.660,44	865.328,67	1.849.296,77	1.670.161.25	31.708 036,36	71.011.160,49
12.500.000 —	600.000 —	10.729.472 —	10.689.830,91	1.247.506,65	1.709.748,19	1.660.356,25	30.821.723,77	69.958.637,77
12.500.000 —	600.000 —	11.039.222 —	10.225.977,49	1.222.428,23	1.738 260,64	1.667.764,05	31.432.300,52	70.455.952,93
12.500.000 —	600.000 —	11.939.517 —	10.093.258,61	1.254.479,52	3.663.679,13	1.691.682,95	31.432.264,10	73.174.881,31
12.500.000 —	600.000 —	17.262.527 —	9.446.846,72	845.201,41	1.545.071,56	1.684.575,55	34.794.388,20	78.678.610,44
12.500.000 —	600.000 —	19.092.577 —	10.482.434,73	1.041.691,97	1.448.312,67	1.667.192,60	31.332.626,20	78.164.835,17
12.500.000 —	650.000 —	20.716.204 —	12.042.895,16	535.686,90	1.717.491,46	1.720.918,05	32.746.582,76	82.629.778,33
12.500.000 —	650.000 —	22.416.107 —	17.700.019,24	620.965,58	1.610.581,95	1.737.205,75	34.711.671,09	91.946.550,61
12.500.000 —	650.000 —	25.034.277 —	20.170.696,17	1.344.264,36	1.522.985,64	1.692.045,95	36.883.777,12	99.798.046,24
12.500.000 —	650.000 —	26.247.202 —	28.393.426,44	3.978.199,88	1.751.699,25	1.997.633,70	38.400.507,89	113.918.669,16
12.500.000 —	650.000 —	27.414.822 —	30.192.467,42	4.131.511,06	2.172.816,22	2.021.701,33	42.743.472,83	121.826.790,86
12.500.000 —	650.000 —	27.469.957 —	32.673.381,19	5.228.282,23	1.892.903,60	2.036.798,94	44.316.387,56	126.767.710,52
12.500.000 —	650.000 —	26.316.302 —	36.856.509,37	7.656.158,45	1.874.208,65	1.270.494,65	50.198.857 —	137.322 530,12

BKSH

BKSH

BILANÇI

BKSH

BILANÇI . ME 31

(ne franga

AKTIV			ndryshime ndaj ushtrimit 1938
AKSIONISTA LLOGARI KAPITAL		8.662.500 —	—
AR		7.567.060,46	— 7.400
DISPONIBILITETE NË LIRA ITALIANE		47.805.455,61	+ 41.084.896
BONA TË THESARIT E TITUJ SHTETI ITALIANË			
skadimi deri në 6 muej	2.280.000, —		
» mâ tepër se 6 muej	11.853.872,45	17.133.872,45	+ 8.591.047
PORTAFOJ SKONTIMESH		3.181.750,96	— 511.892
PARADHANJE TË GARANTUEME		2.128.888,45	+ 502.176
KONT - KORENT AKTIVE		2.540.205,99	+ 1.722.693
PJESMARRJE		312.500 —	—
TË PA TUNDËSHME		1.206.263,11	+ 111.512
MOBILJA DHE SPENZIME IMPIANTIMI		1 —	—
AKTIVITETE TË TJERA		3.583.375,07	— 821.416
		94.121.873,10	+ 50.671.616
EFEKTE PËR INKASIM		1.874.208,65	+ 24.912
DEBITORË PËR DORËZANI		1.270.494,65	— 399.666
PARTITA TË NDRYSHME		38.859.646,31	+ 15.731.612
TITUJ GARANCIJE T'ADMINISTRATORVE		25.000 —	—
SHUMA E AKTIVIT		136.151.222,71	+ 66.028.474

BKSH

DHETUER 1939

shqiptare)

PASIV			ndryshime ndaj ushtrimit 1938
KAPITAL SHOQNUER		12.500.000 —	—
REZERVË		650.000 —	+ 50.000
BILETA NË QARKULLIM		26.316.302 —	+ 15.787.625
DETYRIME ME AFAT TË PËRNJIHERSHËM			
në franga shqiptare	7.656.158,45		
në Lira Italiane	36.856.509,27	44.512.667,82	+ 32.686.298
TË TJERA PASIVITETE		9.685.277,95	+ 2.106.572
TË MBETUNA FITIMI PREJ USHTRIMEVE TË KALUEM		133.952,03	+ 21.496
FITIM I USHTRIMIT		323.673,30	+ 19.625
		94.121.873,10	+ 50.671.616
KREDITORE PËR EFEKTE PËR INKASIM		1.874.208,65	+ 24.912
DORËZANI PËR LLOGARI PERSONASH TË TRETË		1.270.494,65	— 399.666
PARTITA TË NDRYSHME		38.859.646,31	+ 15.731.612
ADMNISTRATORE PËR GARANCIE TË DHANA		25.000 —	—
SHUMA E PASIVIT		136.151.222,71	+ 66.028.474

BKSH

BKSH

SHKOQITJE LLOGARIJE

BKSH

SPENZIME E RANDIME

SPENZIME TË PËRGJITHËSHME	Fr. A.	1.043.145,67
AMORTIZIME MBI PASUNI TË PA TUNDËSHME	»	84.000,—
TË TJERA AMORTIZIME DHE SHVLEFTËSIME	»	68.566,85
INTERESA PASIVE	»	529.693,03
	Fr. A.	1.725.405,55
FITIM I USHTRIMIT 1939	»	323.673,30
	Fr. A.	2.049.078,85

BKSH

E USHTRIMIT 1939

FITIME

INTERESA AKTIVE	Fr. A.	1.341.213,18
FITIME MBI VALUTA DHE MBI VEPRIME FINANCIARE	»	227.488,65
SKONTIME DHE PARADHANJE	»	355.975,53
PROVIXHIONE DHE FITIME TË NDRYSHME	»	124.401,49
	Fr. A.	2.049.078,85

BKSH

BKSH

BKSH

RADHUER I FUNKSIONARVE

(Prill 1940)

Ispektoria në Romë:

Dott. GUIDO CORDOVA – Inspektor i Përgjithëshëm
Z. UMBERTO PICCARDI – Llogaritar i »
Dott. GUIDO DEPAUL – Inspektor
Rag. VINCENZO ZANCANI – »

Drejtoria Qendrore - Tiranë:

Dott. ETTORE MELIS – Bashkëdrejtor Qendrore
Rag. LORENZO MUSANI – Drejtor me shërbim
Rag. UGO OLMASTRONI – Bashkëdrejtor me shërbim
Rag. ANTONIO GARRAMONE – Prokurator në dispozicion
Rag. RODOLFO JANNELLO – » » »

Qendra e Tiranës dhe Agjencija e Elbasanit:

Rag. RAFFAELE RAZZINI – Drejtor
Rag. UMBERTO BENZI – Prokurator
Rag. LUCIO EPPI – »
Rag. MARIO FASSIO – »
Z. QEMAL KARAGJOSI – »

Qendra e Durrësit:

Dott. ALESSANDRO BRESSAN – Drejtor
Rag. MENOTTI STRAMIGNONI – Nëndrejtor
Rag. ERNESTO MARCUCCI – Prokurator

Degë e Korçës:

Rag. MARIO ASTARITA – Drejtor
Rag. EDGARDO BUONACCORSI – Prokurator

Degë e Portit Edda dhe Agjencija e Gjinokastrës:

Rag. GIOVANNI TRAPANI – Bashkëdrejtor
Rag. ANDREA CACCAMO – Prokurator
Z. PIETRO ZANE – »

Degë e Shkodrës:

Rag. ARMANDO BATTISTI – Drejtor
Dott. NICOLA FINO – Nëndrejtor
Rag. TONIN JUBANI – Prokurator

Dëge e Vlonës dhe Agjencija e Beratit:

Rag. GIUSEPPE TERRUSI – Bashkëdrejtor
Dott. ALBERTO BUONI – Nëndrejtor
Z. UGO BELLUZZI – Prokurator

BKSH

BKSTY

INDEKS

Këshilli Administrativ dhe Sindikët	Faqe	3
Relacion i Këshillit	»	5
Pasqyra statistike dhe grafike	»	25
Relacion i Sindikëve	»	33
Gjindjet muejore	»	39
Bilançi	»	43
Shkoqitje llogarije	»	47
Radhuer i funksionarve	»	51

BKSH

BKSTY

BKSH

BKSH

BKSH